



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E SHTIMES

Komisioni për shqyrtimin e ankesave në sektorin e Arsimit
Nr.05-610/01-1765/22 datë:12.05.2022



Npi – 01/116 datë: 13.05.2022

Bazuar në nenin 5 pika (c) të Ligjit, për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068; Nenin 50 dhe 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031; Si dhe në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në sektorin e Arsimit Nr.02/11 të datës 25.01.2022; Komisioni për shqyrtimin e ankesave në mbledhjen e mbajtur më 13.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËR REFUZIMIN E ANKESËS TË XHEVDET SEJDIU

I

Komisioni për shqyrtimin e ankesave në sektorin e arsimit në mbledhjen e -IV- për vitin 2022 të mbajtur më 13.05.2022, unanimisht vendosi të REFUZOI, Ankesën Nr.05-610/01-9730/22 datë: 15.04.2022. të z.Xhevdet Sejdiu, Adresa: Rr."Fatmir Ratkoceri" Nr: 28 Ferizaj. Mbetet në fuqi vendimi i Drejtorisë Komunale të Arsimit Nr.05/212 i datës 01.04.2022, si dhe ndryshimi i kontratës Nr.05/439 për kohë të caktuar nga 01.10.2021 deri 31.08.2022.

II

A r s y e t i m: z.Xhevdet Sejdiu, është ankuar në vendimin e DKA-së me Nr. 05/212, siç ka thënë ai, se "Vendimi për korrigjim të dukshëm" nuk është i drejtë. Si dhe konsideroj se në lidhje me ndryshimin e kontratës Nr.05/439 për kohë të caktuar nga 01.10.2021 deri 31.08.2022 është i njëanshëm, unë e kam pranuar këtë Kontratë si mësimdhënës në SHMLP-Shtime për këtë kohëzgjatje ndryshe nuk do ta kisha pranuar. Komisioni i Ankesave ka konstatuar se Drejtoria Komunale e Arsimit ka vepruar në përputhje të plotë me nenin 50 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031.

III

Udhëzim për mjetin juridik: Pala ka të drejtë, bazuar në nenin 74 pika 2 e Ligjit për zyrtarët Publikë Nr.06/L-114 ku thot: "Ankimi paraqitet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga njoftimi i vendimit" si dhe nën 74 pika 5 ku thot "Nëse ankuesi nuk është i kënaqur me vendimin e organit të ankimit, në afatin vijues prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente".

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë së Arsimit, Kryetarit të Komunës, dhe Zyrës për Informim.

Komisioni Ankesave:

1. Idajet Rexhepi _____

2. Minire Halili _____

3. Naim Hasani _____

